

Qyteti im

Falas



Karnavalet e Korçës – Rikthim në traditë

Kryebashkiaku Peleshi i kërkon Kryeministrit Berisha më shumë investime në Korçë

"Design Charette" sjell mendimin e specialistëve për Zonën Këmbësore



**KORÇA KU
DUA TE JETOJ**



Karnavalet e Korçës

Rikthim në traditë

Karnavalet e Korçës janë rikthim në traditë. Ato janë padyshim festa më e madhe e vitit. Bashkia prej kohësh po investon për ta bërë qytetin më mikpritës, më argëtues, më kreativ.

Niko Peleshi

Në qytetin e Korçës rikthehen karnavalet. Festa që e bëri qytetin e famshëm erdhi këtë vit përmes Festivalit Ndërkombëtar të Karnavaleve të zhvilluar ditën e shtunë më 21 qershor duke shënuar kështu edhe çeljen e Sezonit Turistik. Karnavalet e Korçës, të gëzueshme dhe të zhurmshme, shumëngjyrëshe dhe mjaft të çuditshme përtej normales së jetës së përditshme, u shpërfaqën para syrit të mijëra qytetarëve që kishin mbushur sheshin para Katedrales me të gjithë madhështinë e emrit që ato mbartin, duke risjellë kështu nurin e dikurshëm të karnavalit.



Kanë qenë 30 grupe, prej të cilave 13 nga Korça dhe rrethinat, grupet e karnavaleve nga qytetet e Shqipërisë si Shkodra, Tirana, Kavaja e Berati si dhe grupe të tjera nga jashtë vendit Maqedonia, Mali i Zi dhe Italia, të cilët nëpërmjet larmishmërisë së ngjyrave dhe figurave butaforike, herë gazmore dhe herë komike e groteske, parakaluan duke startuar përmes portave hyrëse të improvizuara me mjeshtëri nga artistët e Qendrës Kulturore "V.Mio".

Parada e grupeve është paraprirë nga kuzhinieri me shishe birre në kurriz, një butafori mjaft e gjetur kjo që u uroi mirëseardhjen veçanërisht turistëve në shtëpinë tonë të madhe, Korçën, duke i ftuar të shijojnë jo vetëm gatimet tona të shijshme, por edhe Birra Korçën edhe bukuritë e resurset e rajonit tonë. Më tej atmosfera është ndezur përmes parakalimit dhe interpretimit të grupeve pjesëmarrëse, ku secili spikati për veçantinë e fabulës dhe të koreografisë, koloritin e pasur të veshjeve, maskave e butaforive të shoqëruara këto nga një muzikë e gjetur, mjaft të fuqishme duke bërë që të gjallëronte i gjithë sheshi, duke e kthyer në këtë mënyrë karnavalin, në festën më të madhe të të gjithë vitit. Parakalimi është ndjekur nga mijëra qytetarë të të gjitha moshave të cilët janë bërë pjesë e Karnavalit.

Festa e Karnavaleve është mbështetur fuqimisht nga AMC dhe Top Channel por edhe nga partnerë të tjerë si Shoqata e Karnavaleve të Shqipërisë, Qendra Kulturore "V.Mio", Birra Korça, Drejtoria Arsimore Rajonale.

I pranishëm në këto festime ka qenë edhe Presidenti i Shoqatës së Karnavaleve të Europës Henri Ferdinand Van der Kroon, i cili e ndoqi të gjithë paradën e karnavaleve nga afër dhe me mjaft interes. I surprizuar nga ky organizim, z.Kroon e vlerësoi maksimalisht këtë shfaqje mjaft të veçantë krahasuar me ato çka ai ka parë. Ai i dorëzoi Kryetarit të Bashkisë Niko Peleshi medaljen e artë të karnavaleve.

Njëkohësisht Presidenti i Karnavalit European, e ftoi Bashkinë e Korçës, të përfaqësojë karnavalin shqiptar në Festivalin European të Karnavaleve që do të zhvillohet vitin e ardhshëm në Malin e Zi, ku do të marrin pjesë 52 grupe nga e gjithë Evropa.



Kryebashkiaku Peleshi i kërkon Kryeministrin Berisha më shumë investime në Korçë



cimit të fazës së dytë të projektit të kanalizimeve në qytet me vlerën 14,5 milion Euro, investim ky i qeverisë shqiptare nëpërmjet Bankës Botërore. Në vijim të vizitës së tij në qytetin e Korçës Kryeministri shqiptar inaguroi tre rrugë të brendshme në lagjet 6, 7 dhe 13, të cilat i lidhin këto lagje periferike me rrugët kryesore. Kanë qenë pikërisht rrugët Ismail Latifllari, Riza Cerova dhe Xhafer C.Lubonja.

Gjatë vizitës ndër të tjera Kryebashkiaku, Niko Peleshi, kërkoj që qeveria të mbështesë:

- Fazën e tretë të projektit të kanalizimeve në qytet prej 15 milion Euro nga qeveria gjermane
- Zonën këmbësore, e cila do të shënojë një hap përpara në zhvillimin urban të qytetit të Korçës duke krijuar më shumë hapësira për qytetarët
- Vënien në dispozicion të godinës së divizionit në funksion të ndërtimit të Universitetit Amerikan.

Kryeministri i Shqipërisë Sali Berisha vizitoi Bashkinë e Korçës ditën e shtunë, në datën 21 qershor, ditë në të cilën u nënshkrua dhe kontrata për ndërtimin e një banese sociale mes Kryebashkiakut, Niko Peleshi, dhe Ministrin të Punëve Publike dhe Telekomunikacionit, Sokol Olldashi. Kjo kontratë kap vlerën 100 milion Lekë dhe do të shërbejë për ndërtimin e një pallati me 8 kate në të cilin do të strehohen 40 familje. Bashkia Korçë ka vënë në dispozicion truallin për ndërtimin e kesaj banese dhe ka gati studimin e saj. Një tjetër marrëveshje e rëndësishme u formalizua po këtë ditë edhe me Ndërmarrjen e Ujësjellës - Kanalizimeve, e cila i hapi rrugë finan-

Qyteti së shpejti me një sistem të standartizuar adresash

Në mbledhjen e qershorit, Këshillit Bashkiak miratoi përfshirjen e Bashkisë Korçë në Projektin LAMP, Projekti për Menaxhimin dhe Administrimin e Tokës. LAMP është një bashëpunim i qeverisë shqiptare me Bankën Botërore, i cili i hap rrugë fillimit të punës për hartimin e Planit të Ri Rregullues të qytetit.

Grupet e punës me përbërje nga institucione të ndryshme të qytetit kanë përfunduar fazën e parë e inventarit bazë dhe po punojnë për inventarin e detajuar. Mbi bazën e një vlerësimi të kryer nga Banka Botërore, Bashkia e Korçës ka marrë 14 pikë nga 15 të mundshmet. Nisur nga ky rezultat maksimal, LAMP parashikon të investojë dy objekte të cilat do të zgjidhen nga prioritetet e investimeve të Bashkisë të dërguara në Ministrinë e Pushtetit Vendor.

Pjesë e projektit LAMP është edhe sistemi i adresave ku janë përcaktuar emrat e rrugëve e shesheve në të gjithë qytetin. Sistemi i adresave që mori miratimin e Këshillit Bashkiak është i plotë dhe i standartizuar sipas kërkesave të Ministrisë së Brendshme. Bashkia në këtë proces merr përsipër vendosjen e tabelave.

“Design Charette” sjell mendimin e specialistëve për Zonën Këmbësore

“Zonat Këmbësore, një nevojë për të frenuar zhvillimin urban spontan dhe të paorientuar”

“Design Charette”, ka qenë praktika e përdorur për të tërhequr mendimin e specialistëve për projektin e Zonës Këmbësore tek Bul. “Shën Gjergji” në qytetin e Korçës. Kjo praktikë është e njohur në Europë për promovimin e zonave këmbësore dhe aplikohet për herë të parë në vendin tonë nga Bashkia e Korçës.

Së bashku me këtë praktikë të re, i gjithë procesi që ka ndërmarrë Bashkia për zhvillimin e projektit të Zonës Këmbësore është mjaft demokratik dhe gjithpërfshirës. Si ide fillestare ajo është hedhur e përkrahur në “Forum urban” në shtator të vitit të kaluar, më pas është konkretizuar me projektidetë e dy arkitektëve Aleko Papakozma e Vladimir Bregu të cilat janë afishuar duke tërhequr edhe mendimin qytetar, proces i cili është shoqëruar me sondazhe. “Design Charette” ishte një formë mjaft origjinale ku arkitektë, urbanistë, ndërtues etj, me anë të dizenjimit mbi skicë propozuan konkretisht ide dhe sugjerime për Zonën Këmbësore.

Disa nga propozimet e përzgjedhura nga Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Hartimit të Projekteve janë:

- Monumenti “Ushtri i Panjohur” të spostohet në vendin ku është vendosur fillimisht nga autori dhe të shoqërohet nga pas me një pasqyrë ujore, me aks, aksin e Bul. “Shën Gjergji”
- **Gjërësia e rrugës në pjesën para Katedrales “Ringjallja e Krishtit”, të jetë 9,5-10,5 m (një variant i mundshëm, të jetë e shtruar me gurë)**
- Të krijohet një shesh parkimi sipërfaqësor përgjatë Rrugës “Konferenca e Pezës” në anë të Lulishtes “V. Mio”
- **Rikonstruksioni i Pallatit mbi ish MAPO të bëhet në stilin neoklasik**
- Objektet që do të ndërtohen në zonën e qendrës (Rr. “Ligor Rëmbeci”, etj) Të parashikohen me dy kate parkim nëntokë
- **Sheshi para Teatrit “A.Z.Çajupi” të zgjidhet me parkim sipërfaqësor në qendër e duke unifikuar gjërësitë e rrugëve**
- Të kosiderohet shesh parkimi pas ish MAPO si dhe tek Blloku “Rinia” e tek Agjensia e Udhetarëve
- **Të parashikohet vendosja e një kolektori për mbjdhjen e ujrave të shiut, përgjatë Bul. “Shën Gjergji”, në rastin e ndërtimit në perspektivë të nënkalimit tek sheshi i qendrës**



Bashkia në Ditën Ndërkombëtare të Mjedisit

Në ditën Ndërkombëtare të Mjedisit Bashkia Korçë nëpërmjet firmës së kontraktuar të pastrimit të qytetit "Korsel" dhe aktorëve lokalë të përfshirë, kanë ndërrhyrë në pikat më problematike të qytetit duke kontribuar "Për një Korçë më të pastër" i cili është edhe slogan i të gjithë fushatës sensibilizuese që ka ndërmarrë Bashkia Korçë dhe që ka një shtrirje kohore gjatë gjithë vitit.



Kanë qenë punonjësit e Bashkisë të cilët kanë startuar veprimtaritë e kësaj dite me lyerje pemësh përgjatë Bul. "F.Noli", e cila ka vijuar më tej me lyerjet e pemëve përgjatë Bul. "Shën Gjergji" nga punonjësit të Pro Credit Bank si dhe të rinjtë e Organizatës "Fusion" tek Bul. "Republika". Më tej i ka takuar Firmës së Pastrimit "Korsel" që mbajti edhe peshën më të madhe të kësaj dite, duke evaduar mbeturina tek ish Konvikti dhe ish Parku i Industrisë të cilat ishin konsideruar nga Bashkia si zonat më të ndotura të qytetit. Ndërkohë, punonjësit të Eco -Shërbimit kanë hequr mbeturina tek Këndi Sportiv, Poshtë Kishës Katolike, Stacionit Urban dhe mbrapa Raiffeisen Bank. Aksioni u mbështet edhe nga Ambasadorët e Paqes dhe nxënësit e shkollave të mesme të cilët bënë pastrimin e oborreve dhe lyerjen e kangjellave.

Nuk munguan në këtë ditë edhe ekspozita me projektet mjedisore të mbështetura nga SIDA si dhe shpërndarja në rrugë dhe tek njësitë e biznesit e materialeve promotionale: "Për një Korçë më të pastër" e cila përmbante një ekstrakt të Rregullores së Pastrimit si dhe sanksionet ligjore në rast shkeljesh.

Aktorët që mbështetën ditën e mjedisit: Pro Credit Bank, SIDA, Eco -Shërbimi, Korsel, Drejtoria Arsimore Rajonale, Ambasadorët e Paqes, Mjafit, Senati Rinor, Gruaja Korçare.

Themelohet Kompania "Menaxhimi i Mbetjeve Urbane sh.a. në Qarkun e Korçës"

28 kryetarë komunash dhe bashkësi të Qarkut të Korçës që nga Hudënishti në Veri deri në Ersekë në Jug u takuan për të themeluar Kompaninë "Menaxhimi i Mbetjeve Urbane në Qarkun e Korçës"sh.a.

Në këtë mbledhje kanë qenë të pranishëm Kryetari i Bashkisë Korçë Niko Peleshi, Ministri i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave Lufter Xhuveli, Ministri i Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit Sokol Oldashi si dhe përfaqësuesi i KFW-së Salih Yldirim të cilët kanë përshëndetur krijimin e kompanisë.

Asambleja e Përgjithshme Themeluese e Shoqërisë së Administrimit të Mbetjeve të Qarkut të Korçës nënshkroi Aktin Themelues dhe Statutin e Shoqërisë.

Menaxhimi i mbetjeve urbane, është një përpjekje e përbashkët e Bashkisë Korçë me komunat e tjera të Qarkut për të krijuar një sistem të ri në menaxhimin e mbetjeve urbane duke kontribuar ndjeshëm në përmirësimin e mjedisit. Kompania do të jetë përgjegjëse jo vetëm për mbledhjen, transportin dhe grumbullimin e mbetjeve, por edhe për pakësimin e sasisë së mbetjeve përmes riciklimit.

Bashkitë dhe komunat e Qarkut të Korçës, janë mbështetur në përpjekjet e tyre për krijimin e kompanisë, nga projekti i financuar nga KFW-ja gjermane, i cili njihet si insitucioni financiar me përfshirjen më aktive në menaxhimin e ujit të pijshëm, ujrave të përdorura dhe së fundmi në menaxhimin e mbetjeve urbane në Qarkun e Korçës.



Masa urgjente në ndihmë të banorëve të pallatit të djegur

Biznesi i ndërtimit ndihmon në rikonstruksionin e godinës

Të hënën e 23 qershorit, një pallat tre katësh në Rrugën “Partizani” të qytetit të Korçës u përfshi nga flakët. Shkak u bë shpërthimi i një bombule gazi në një nga apartamentet e këtij pallati, ku flakët shumë shpejt, edhe pas ndërhyrjes së zjarrfikseve, përfshinë gjithë katin duke djegur gjithçka në këtë kat dhe duke rrezikuar seriozisht jetën e banorëve. Menjëherë Kryetari i Bashkisë, Niko Peleshi, ngriti Shtabin e Emergjencës pas së cilit u morën masa për evakuimin, strehimin dhe sigurimin e ushqimit ku një kontribut të madh dha Drejtoria Arsimore Rajonale. Po kështu për banorët më në nevojë, të cilët pësuuan dëme materiale nga zjarri, Bashkia ndërmjetësoi me organizatat humanitare si Kryqi i Kuq dhe Dorkas duke siguruar për ta ushqime dhe veshmbathje. Nga ana tjetër, Komisioni i Vlerësimit të Dëmvë në Bashki, shkoi në vendngjarje dhe bëri vlerësimin e dëmeve materiale duke përshpejtuar procedurat për kompesimin e tyre.

Ajo çka është për t'u vlerësuar është gadishmëria dhe ndihma e menjëherëshme e dy bizneseve të ndërtimit në qytet, Beton Plus dhe Konstruksion 93, të cilët filluan menjëherë nga puna për rikonstruksionin e godinës me shpenzimet e tyre. Bashkia Korçë gjen rastin t'i falenderojë për humanizmin dhe veprimin e lartë qytetar. Edhe stafi i Bashkisë u solidarizua me biznesin duke kontribuar financiarisht për familjet e prekura nga kjo fatkeqësi.

Specialistët: Muret ndarëse lokalizojnë vatrën e zjarrit

Marrë shkak nga ngjarja, urbanistët e Bashkisë Korçë kryen një studim paraprak për të identifikuar banesat të cilat kanë risk të lartë në rast zjarri. Në bazë të këtij studimi, u identifikuan mbi 60 banesa kolektive të ndërtuara ndërmjet viteve 1940 - 1960 të cilat janë po kaq të rrezikuara sa pallati në fjalë për shkak të konstruksionit të çatisë me dërrasa e koce. Këto materiale digjen mjaft shpejt dhe është pothuajse e pamundur të shuhen nga zjarrfikëset pasi flaka përhapet me shpejtësi të madhe. Specialistët sugjerojnë ndërtimin e mureve ndarëse në tarracën e këtyre banesave të cilat ndihmojnë ndjeshëm në lokalizimin e zjarrit.



Fëmijët, protagonistë në ditën kundër punës së fëmijëve

200 fëmijë nga katër shkollat periferike të qytetit Ismail Qemali, Naim Frashëri, Nuçi Naçi e Demokracia, u bënë protagonistë në Ditën Ndërkombëtare Kundër Punës së Fëmijëve duke hedhur mesazhet: Ndal dhunës! Ndal punës! Tubimi i OJF-ve rrome tek sheshi para Katedrales me moton: “Lypja gjymton të ardhmen e fëmijëve!” dhe mesazhi i përcjellë për qytetarët nëpërmjet fletëvolanteve: “Monedhat tuaja ushqejnë shfrytëzimin e fëmijëve!” u pasua me koncertin në Teaterin “A.Z.Çajupi”

Mjaft fëmijë që dolën në skenë duke kënaqur bashkëmoshtarët e tyre përmes interpretimit në aerobi, këngë e recitim, ishin ata të cilët në sajë të punës së Njësisë së Mbrojtjes së Fëmijëve pranë Bashkisë Korçë, i janë larguar rrugës duke iu kthyer bankave të shkollës. Aktiviteti ishte një bashkëpunim mes Bashkisë Korçë, Fondacionit Terre des Hommes dhe Drejtorisë Arsimore Rajonale.





Zhuljeta Sheremeni - soprano



Koço Ristani - piktor



Agim Hakiu - instrumentist popullor



Guri Koco - regjisor



Vladimir Topi - skulptor



Llazi Serbo, Artist i Merituar - regjisor



Ilia Lulo - flautist



Jorgaq Nano, Artist i Merituar - dirigjent



Pandi Bello - muzikolog



Eli Fara - këngëtare



Petrika Riza - aktor



11 artistët më të mirë korçarë të vitit 2007 u vlerësuan nga Bashkia e qytetit në mbrëmjen e madhe të ndarjes së çmimeve "Protagonist 2007".

Ata u ngjiten të sigurt në skenën e teatrit "A.Z.Çajupi" pasi e kanë matur artin e tyre jo vetëm me njëri-tjetrin por edhe me artistë nga rajoni e bota. Kështu, tre çmime kanë shkuar për artistët e skenës. Çmimin "Aktori më i mirë" e ka merituar Petrika Riza, çmimi "Prezantimi Dinjitoz" ka shkuar për regjisorin Llazi Sërbo ndërsa çmimi "Regjisori më i mirë" i ka takuar Guri Koços. Çmime janë ndarë edhe për artistët në fushën e muzikës. Ndër to, "Çmimi i karrierës" ka shkuar për drejtuesin e Korit "Lira", Artistin e Merituar Jorgaq Nano, çmimi "Këngëtari më i mirë" i jepet sopranos Zhuljeta Sheremeni, çmimi "Instrumentisti më i mirë" i është dhënë flautistit Ilo Lulo, ndërsa atë të instrumentistit popullor më të mirë e meritoi Agim Hakiu. Një çmim i veçantë iu dha këngëtares popullore Eli Fara për kontributin e saj në skenat kombëtare dhe ndërkombëtare. Ndërkohë që çmimi "Skulptori" dhe "Piktori më i mirë" u ka takuar përkatësisht Vladimir Topit dhe Koço Ristani.

Në fund të spektaklit ka qenë Kryetari i Bashkisë Niko Peleshi i cili ka dorëzuar çmimin më të rëndësishëm, atë të personalitetit më të spikatur të qytetit të cilin e ka merituar muzikologu Pandi Bello, i cili u vlerësua nga Kryebashkiaku Peleshi si eruditi më i spikatur i kohëve tona.

Aktiviteti i Bashkisë Korçë dhe Qendrës Kulturore "V. Mio" u mbështet nga Banka Popullore, Teatri "A.Z.Çajupi", me sponsor gjeneral AMC.



“U bë kohë që s’jemi parë” - Ekspozitë nga Guri Madhi

“U bë kohë që s’jemi parë” u titullua ekspozita e piktorit të madh korçar Guri Madhi, e cila u çel në galerinë që mban emrin e tij. Inisiativa e trashëgimtarit të tij Pandit, u përkrah pa hezitim nga Bashkia e qytetit. Ekspozita vjen në Korçë pas 20 vjetësh, më një titull sinjifikativ, që në mënyrë krejt të ligjshme simbolizon në retrospektivë mallin dhe dëshirën e artistëve për ta pasur më afër piktorin Guri Madhi nëpërmjet veprës së tij. Në galeri u ekspozuan 20 nga 400 veprat e krijimtarisë së tij. E veçanta ishte se një pjesë e tyre janë të paekspozuara më parë. Ato shënojnë fillimet e karrierës së tij siç ishin grafikata, kryesisht portrete, duke vazhduar me punimet në vaj, tablo të përmasave të mëdha me përmbajtje kryesisht historike ku atmosfera duket sikur lëviz e gjitha. Pjesa më e madhe e tyre janë realizuar me penelata të lira, me kolorit ngjyrash dhe efekte dritash.

Koncert me këngë tërësisht shqiptare

Një koncert me këngë tërësisht shqiptare duke përfshirë edhe polifoninë. Kanë qenë të mirënjohurit, sopranoja Mimoza Kosturi e shoqëruar nga i madhi Robert Radoja në piano, Suela Piciri në violinë dhe Aristidh Frosi në violonçel, të cilët me iniciativën e Qendrës Kulturore “V. Mio” dhanë një koncert të një niveli të lartë artistik. Për artdashësit e shumtë të pranishëm në sallën e koncerteve të kësaj qendre, janë kënduar romanca vokale si dhe këngë popullore nga trevat e Korçës dhe të Shkodrës të përpunuara për trio muzikore nga kompozitorët më të mëdhenj shqiptarë. Krahas gjinive të sipërpërmendura, grupi i polifonisë këndoi këngë polifonike nga himariote e zagoriote.

Sezoni Koncertor i Muzikës me dy koncerte vokal-instrumentale

Në vijim të Sezonit Koncertor të Muzikës, në Sallën e Concerteve të Qendrës Kulturore “V.Mio”, muaji qershor u çel me dy koncerte vokal-instrumentale. Në të parin, sopranoja ruse me banim në Greqi Ksenja Cafkopulo e cila ka marrë titullin “Master” nga Konservatori Shtetëror i Selanikut, u shoqërua në piano nga Kostaq Vrame dhe Marjanti Vrame, të njohur për artdashësin për interpretimin “Piano me katër duar”. Në program bënin pjesë romanca, arie dhe këngë popullore ukrainase të klasikëve të njohur botërorë Mozart, Ravel, Puçini.

Ndërsa në programin e datës 6 qershor, interpretoi një tjetër trio. Ka qenë soprano Zhuljeta Sheremeni, interpretimi i së cilës u shoqërua në piano nga Entela Kotelli dhe në violinë nga Erion Marku. Gjatë këtij koncerti u interpretuan me mjeshtëri vepra të një shkalle të lartë vështrësia nga kompozitorë të mëdhenj si Belini, Verdi, Rossini.

“Ku më mbete ti rini” – Sherif Merdani në skenën korçare

Sherif Merdani, këngëtar i idhull i rinisë së viteve ‘70 i rikthehet qytetit të tij të lindjes, Korçës, pas 35 vjetësh me një koncert tërësisht të tijin. Në programin e përzgjedhur për

spektorin, krahas këngëve të mirënjohura të muzikës së lehtë shqiptare, hiteve të huaja, u ekzekutuan edhe pjesë instrumentale nga Beatles dhe Shopen të interpretuara në piano nga djali i artistit Gerald.

Spektatori i pranishëm duartrokiti dhe këndoi së bashku me Sherifin këngët e tij tashmë mjaft popullore: “Pse kënduam Let it be”, “Nënës”, “Simfonia e nënës”, “Fqinjës” etj. E veçanta e recitalit ishte se Sherifi këngëtar ishte edhe Sherifi prezantues, ku artisti i dha vetes mundësinë të komunikojë më gjatë dhe të ndajë me spektatorin e sallës së Teatrit “A.Z.Çajupi” dhimbjen e largimit nga skena dhe të dënimit të pamerituar si dhe të rrëfijë copëza nga jeta e tij duke i përcjellë ato nëpërmjet mesazheve mjaft të fuqishme.

Më shumë ngjyra i dhanë recitalit edhe dalja në skenë e të ftuarave të nderit, këngëtareve të njohura Vikena Kamenica dhe Anjeza Shahini.

Netët korçare të poezisë në vazhdim të traditës

“Netët korçare të poezisë”, manifestimi poetik i cili ka hyrë në traditën e Korçës u zhvillua në datat 6 deri 8 qershor 2008. Në ceremoninë e hapjes, poetët e ftuar nga Shqipëria, Maqedonia, Kosova, Greqia dhe Bosnja i përshëndeti Nënkrjetari i Bashkisë Sotirag Filo.

Çmimet:

❖ “Kurora e Poezise” (Çmimi i Karrierës)	Hamza Koçiu (Korçë)
❖ “Asdreni”	Demir Gjergji (Tiranë)
❖ “Skënder Luarasi”	Aleko Ballauri (Korçë)
❖ “Seferis”	Rakela Yzeiri (Greqi)
❖ Poezia më e mirë për Korçën”	Agim Bajrami (Durrës)
❖ “Poezia Erotike”	Klito Fundo (Korçë)
❖ “Surpriza 2008”	Seida Beganović (Bosnje)
❖ “Çmimi Special”	1. Dhimitër Pojanaku (Pogradec)
	2. Adem Abdulla (Maqedoni)

“Pranvera 2008”, ekspozita e përvitshme e artistëve figurative korçarë

70 vepra në pikturë, skulpturë dhe fotografi u ekspozuan në Galerinë “Guri Madhi” në ekspozitën e titulluar “Pranvera 2008”. Në ekspozitën e përvitshme, të kthyer tashmë në traditën e Qendrës Kulturore “V.Mio”, 27 autorë nga Korça e Pogradeci, prezantuan krijimet e tyre më të reja. Ekspozita përgjithësisht u dallua për stilin tradicional si në teknikë ashtu edhe në tematikë, por ka pasur edhe disa tendenca abstraksioni të stilit modern.

“Lejlekët nuk vijnë më” një libër nga Pëllumb Kulla

Pëllumb Kulla, krijuesi i një sërë figurash mjaft popullore si Lipe Shtogu, Shoku Niqifor, apo “Po martojmë Malon” etj, u prezantua para lexuesit me librin e tij më të ri me tregime “Lejlekët nuk vijnë më”. Krijimet e Kullës si në fushën e dramës por edhe atë të humorit dhe letërsisë, njihen për mprehtësinë e temave dhe humorin e hollë popullor. Pas promovimit të librit të tij para studentëve e pedagogëve të Universitetit “F.Noli”, Pëllumb Kulla u ftua për një vizitë në Bashkinë e Korçës ku u prit nga Nënkrjetari Arjan Bejko dhe një pjesë e stafit. Disa nga krijimet e tij letrare, autori ia dhuroi bibliotekës së qytetit.

PANDI BELLO tek “Qyteti im”

*“Nëse në Korçë troket në dy dyer,
në njërin gjen një zë të bukur”*

Pandi Bello është diplomuar në vitin 1980 në Institutin e Lartë të Arteve, dega Dirigjim dhe Muzikologji.

Në vitin 1991 mbron Doktoraturën në Tiranë. Ka qënë punonjës në Akademinë e Shkencave dhe pedagog i jashtëm në Akademinë e Arteve.

1993-1997 ka punuar në Rumani si punonjës shkencor në Muzeun e fshatit Bukuresht dhe si pedagog në Liceun Kombëtar të Koreografisë së Bukureshtit.

Në vitin 2001 merr titullin Doktor i Shkencave të Muzikës.

Prej disa vitesh është drejtor i shkollës së Mesme Artistike “Tefta Tashko Koço” në qytetin e Korçës.

Ne spektaklin “Protagonist 2007” vlerësohet si “Personaliteti më i shquar në kulturë dhe art për vitin 2007”



Pandi Bello
tek “Qyteti im”

Qyteti im: Sa e rëndësishme është të vlerësohen artistët për kontributin e tyre

Pandi Bello: Kështu ndodh në një shoqëri të civilizuar, megjithë konsumizmin e shoqërisë të sotme. Nëse në një shoqëri të civilizuar vlerësohet diçka si ç'ndodh dhe në botë, kjo prek së pari anën subjektive të personit i cili ndjen se diçka është e miratuar nga një opinion i tërë dhe së dyti, në aspektin social, ky është një sistemim vlerash, që e bën vetë shoqëria, duke përqafuar atë që është e rëndësishme si vlerë krijimtarie dhe kulture dhe duke menjanuar zhvillimet e cilësuar si antikulturore sot.

Qyteti im: Si e vlerësoni jetën artistike të Korçës në këtë periudhë?

Pandi Bello: Unë mendoj se nuk ka patur asnjë periudhë tjetër kaq intensive dhe kaq të larmishme në aktivitetet artistike. Mbase një gjini mund të ketë spikatur më shumë se një tjetër e diçka mund të jetë anashkalluar. P.sh. Korça nuk ka një orkestër simfonike por kjo nuk është shumë

shqetësuese në një kohë kur janë “shuar” 11 orkestra simfonike në vend. E rëndësishme është që ajo që ndodh të ketë standart dhe për fat të mirë Korça e ka standartin e një kulture të lartë kompetitive për shkak se një pjesë e aktiviteteve kombëtare dhe ndërkombëtare kanë qënë garuese dhe unë me këtë rast duhet të falenderoj publikisht qytetin e Korçës, i cili kur e ndjen se diçka është me vlerë afrohet. Në fushen e muzikës ka qënë rasti i Festivalit të Koreve Klasike të Dhomës, ku morën pjesë 8 kore të huaj dhe 3 kore shqiptare, ndër të cilët dhe Kori “Lira”. Shumica e këtyre koreve kishin një nivel të jashtëzakonshëm. Këto nivele, publiku korçar jo vetëm që i meriton pasi ka një sentiment të veçantë ndaj kulturës korale dhe nga ana tjetër, një gjë e tillë është e mundur të ndodhë vazhdimisht në Korçë.

Qyteti im: Jo vetëm prej shkollës artistike “T.T.Koço” që ju drejtoni por edhe për shkak të traditës së hershme muzikore, a keni besim z.Bello se Korça mund të jetë një kryeqëndër kulturore e Shqipërisë së Jugut, duke iu rikthyer traditës të saj të hershme ? Sa optimist jeni për këtë?

Pandi Bello: Korça është kryeqytet i Toskërisë në një kuptim spiritual dhe kështu do të mbetet. Nga ana tjetër m.q.s unë jam drejtor i shkollës së muzikës, në kushtet e tanishme dhe të mëvonshme të Korçës ekzistenca e një shkolle të kësaj natyre është shumë e rëndësishme. Vlerat e kësaj shkolle dokumentohen në qytet, duke marrë parasysh nga njëra anë mësuesit dhe nxënësit, por nga ana tjetër edhe furnizimin e formacioneve të qytetit. Pak a shumë muzikantët që bëjnë jetën artistike në qytet janë produkt i kësaj shkolle. Në këto momente pas më shumë se 50 vitesh ekzistencë, shkolla e muzikës ka më shumë se 100 titullarë muzikantë të cilët punojnë në një diametër me mijëra kilometra nga Vankuver dhe Siatell e deri në Letoni duke u shtrirë në këtë hapësirë të madhe Amerikano-Europiane. Shumica e tyre janë profesionistë në fushën e tyre. Ajo që ju mendoni se Korça do të kthehet në një “kryeqytet” kulturor zonal, për mua është e vlerësueshme dhe këtu unë kam spazmat e mija të optimizmit dhe pesimizmit, por në fund këtë gjë e shoh si pozitive. Por ama kjo s’mund të ndodhë vetvetiu. Kjo kërkon veç pushtetit lokal edhe vëmendjen e pushtetit qëndror për të stimuluar një zhvillim polikulturor në Korçë, pasi jo vetëm tradita por edhe kushtet gjeopolitike dhe shkëmbimet kulturore e favorizojnë. Korça meriton të ketë më shumë vëmendje.

Qyteti im: A ka shumë komercializëm muzika shqiptare sot duke u bërë kështu shkak për deformimin e shijeve të publikut?


Pandi Bello: Pas një qëndrimi të gjatë jashtë vendit jam kthyer në Shqipëri në vitin 1998 dhe në atë moment kam qënë i alarmuar nga një sulm “barbar” ndaj kulturës shqiptare, specifikisht ndaj asaj muzikore. Sot shumë gjëra janë filtruar në kohë e të tjera ende jo. Unë mendoj se duhet të ekzistojë një censurë profesionale e cila lidhet me veprimin efikas të shtetit bazuar në ligjet që ai ka. Opinioni edhe pse nuk është i përbërë nga profesionistë, mund të ndikohet pozitivisht ose negativisht. Duhet ndarë kultura e konsumizmit nga vlerat e vërteta. Edhe vlerat e krijuara në kohë nuk mund të fshihen me një të rënë të lapsit.

Qyteti im: Një vlerë e patjetërsueshme dhe identifikuese e kulturës korçare është dhe serenata. Mendoni se është ruajtur mirë apo dhe ajo nuk i ka shpëtuar komercializmit dhe deformimeve?

Pandi Bello: Serenata është një vlerë e rrallë. Disa ditë më parë kam parë dirigjentin e famshëm Zubin Mehta të drejtonte orkestrën e San Karlos dhe një kor të madh para një publiku mbi 100 mijë veta, që duartrokiti simfoninë e 9-të të Bethovenit dhe kryevepra të tjera të muzikës klasike. Por në fund i gjithë kori këndoi “O sole mio” pra një serenatë. Kështu një nga dirigjentët më të mëdhenj në botë, Zubin Mehta, di të vlerësojë një kulturë të tillë si ç’është serenata. Serenata korçare është sulmuar shumë sikur është greke apo i një opinioni të caktuar. Nuk ka asnjë diskutim më: Serenata është një fenomen muzikor vetëm i Korçës. Këtu është fjala për krijimtarinë, rritjen dhe historinë e saj. Nëse flasim se kush do ta ruajë përgjigjia është në rradhë të parë korçarët, jo për shkak të konservatorizmit provincial, por për shkak se ajo është e lidhur me jetën dhe historinë e qytetit. Kjo krijimtari ka të bëjë me jetën sentimentale të njeriut. Dhe kjo edhe kur ty të duket se s’ka të bëjë me artin e madh, ka vlerë.

Qyteti im: Këto vite mos i kanë dhënë serenatës një deformim të pakorrigjueshëm?

Pandi Bello: Deformimet kanë qënë të pranishme që në fillim e mund të jenë dhe në vazhdim por jo të pakorrigjueshme. Duhet të kthehemi në origjinën e gjërave e nëse jemi të mbështetur në origjinë, ekzistojnë të gjitha mundësitë që ajo të paraqitet aktuale pa shkëputur lidhjet. Duhet të themi dhe disa të vërteta pasi siç thoshte dhe profesori im njohës i madh i vokalit: “Nëse në Korçë troket në dy dyer, në njërin gjen një zë të bukur”.



Qyteti im - Vështrim në kohë

Vijon nga numri i kaluar

Në kushtet e një shtypjeje të dyfishtë nga njëra anë e pushtetit turk dhe nga ana tjetër e Fanarit grek (Patrikanës së Stambollit), ishte shumë e vështirë mësimi në shkollë i gjuhës amtare. Populli i Korçës nuk mund të kënaqej gjatë me këtë gjendje. Një nga kërkesat themelore të Lëvizjes së Rilindjes Kombëtare ishte përhapja e gjuhës dhe kulturës shqiptare. Në këtë lëvizje u përfshi dhe Korça me qarkun e saj. Një plejadë e tërë veprimtarësh si Naum Veqilharxhi, Thimi Mitko, Thimi Marko, Petro Nini Luarasi, Mihal Grameno e të tjerë, u rreshtuan krahas emrave të shquar të Rilindjes Kombëtare. Një nga pionerët e kësaj lëvizjeje ishte Naum Veqilharxhi që më 1844 botoi abetaren e parë shqipe. Duhej të kalonin shumë vite pas kësaj deri sa të arrihej me luftë e përpjekje të merrej leja zyrtare për çeljen e shkollës së parë shqipe në Korçë, më 7 mars 1887, me drejtor Pandeli Sotiri. Me përpjekje të mëdha patrioti Gjerasim Qirjazi mundi të hapë në Korçë më 1893 shkollën e parë shqipe për vajza, ku jepte mësim e motra, Sevastia.

Si rezultat i këtij zhvillimi u rritën dhe niveli dhe kërkesat kulturore të qytetarëve.

Rezultati i punës së madhe që kryen patriotët në këtë kohë, me nismën e Pandeli Cales, u themelua në Korçë më 1 Tetor 1908 shoqëria kulturore-patriotike "Banda e Lirisë", e cila pati edhe bandën e saj. Në vitin 1909 u themelua po në Korçë shoqëria "Lidhja Orthodhokse". Të gjitha këto veprimtari patriotike të kësaj kohe drejtoheshin sidomos nga Komiteti i Fshehtë "Shoqëria e Zezë për Shpëtim". Vlen të përmendim një nga ngjarjet kryesore të luftës për çlirim kombëtar në qarkun tonë. Në datën 14 Shkurt 1910, në kodrat e qytetit u mbajt një manifestim i fuqishëm popullor në mbrojtje të alfabetit latin për gjuhën shqipe. Ky manifestim hyri në histori e njihet me emrin "Mitingu i Shkronjave", me pjesëmarrjen e rreth 15.000 njerëzve.

Vazhdon në numrin e ardhshëm

Shënim: Të dhënat historike dhe hipotezat e paraqitura në këtë artikull nuk prezantojnë një qëndrim zyrtar të stafit të gazetës.

Përgatiti Niko Kotherja



Burime:

LIBRAT:

- "Fjalori enciklopedik shqiptar", Tiranë, 1985
- "Korça, në faqet e historisë", Emin Selenica
- "Një faqe historike", Nikollaq Zoi, Korçë, 2000
- "Korça - urbanistika, arkitektura", Piro Thomo
- "Mbi themelomin e Korçës" (broshurë) Arben Gjata
- "Shqipëria më 1928", Teki Selenica, Tiranë, 1928
- "Shqipëria e ilustruar më 1928", Teki Selenica, Tiranë, 1928
- "Korça dhe fshatrat përfaqar", Nuçi Naçi, Sofje, 1901
- "Korça dhe katundet e qarkut" (ribotim i plotësuar), Nuçi Naçi, Korçë, 1923
- "Historia e Shqipërisë" vëll. II, Tiranë 1965
- "Themistokli Gërmenji", Piro Tako, Tiranë, 1988

GAZETAT:

- (Koleksione pranë Bibliotekës "Thimi Mitko" dhe Bibliotekës Kombëtare Tiranë)
- "Korça" drejtuar nga Sami Pojani e Lytifi Zavalani, Korçë, 1908-1910
- "Lidhja othodokse", drejtuar nga Mihal Grameno, Korçë, 1909
- "Koha" drejtuar nga Mihal, Mina e Koço Grameno, Korçë, 1911-1926
- "E drejta", drejtuar nga Leonidha Naçi, Korçë, 1924
- "Gazeta e Korçës", drejtuar nga Zhan Gorguzi. Koleksion i viteve 1930-1935



Ushitari i Panjohur

Monumenti i Luftëtarit Kombëtar, ose siç e njohim të gjithë “Ushitari i panjohur”, vepër e Odhise Paskalit, i ngritur në vitin 1932, ndodhet sot në sheshin kryesor të qytetit të Korçës para Katedrales “Ringjallja e Krishtit”. Kjo vepër artistike hyn në listën e Monumenteve të Kulturës në Korçë dhe zë një vend të veçantë në historinë tonë të skulpturës monumentale.

Figura e fortë dhe energjike e statujës paraqitet në një moment vrojtimi dhe gadishmërie. Luftëtari është në këmbë, veshur me kostumin kombëtar të fshatarëve të jugut dhe qëndron rëndë mbi këmbën e majtë. Ai është luftëtar malesh, i mbathur me opinga. Koka është e kthyer paksa djathtas me një vështrim të hedhur diku larg. Flokët e gjata e të hapura paksa nga era i japin tipare burrërore, fytyra e tij e vrenjtur dhe e ashpër, tregon revoltimin, shpirtin e pastër dhe karakterin e tij të gjerë.

Kjo skulpturë e çmuar i përgjigjet temperamentit shqiptar: I guximshëm, burrëror, thellësisht paqedashës, mikpritës dhe me virtyte të mëdha, mbrojtës i atdheut të vet. Ky monument hyri menjëherë në shpirtin e shqiptarit.

Ngado që ta shohësh atë do të lexosh qartë lidhjen mes subjektit dhe siluetës së tij shprehëse. Zgjidhja dhe interpretimi i veshjes luan një rol të madh në këtë vepër. Megjithëse fustanella e sidomos guna prej leshi është mjaft e rëndë, veshja nuk e mbulon figurën, nuk e dobëson atë përkundrazi, e nënvizojnë më qartë forcën e burrërisë së tij.

Monumenti i Luftëtarit Kombëtar në Korçë është jo vetëm ndër skulpturat e para monumentale në vendin tonë, por edhe ndër më të mirat.

Aty nga viti 1927, kur Odhise Paskali ishte ende student, u thirr në Korçë për të punuar statujën, që duhej të simbolizonte çmimin e Shqipërisë prej zgjedhës turke. Kryetari i Bashkisë së asaj kohe kërkoi që ai ta bënte skulpturën si një ëngjëll ndërsa një këshilltar e përfytyroi që ta bënte këtë ëngjëll me kurorë në dorë.

Odhiseja 24 vjeçar e përfytyronte ndryshe këtë skulpturë, këtë simbol të lirisë. Duke kujtuar vegjëlinë, fshatin Koblar të Përmetit, i doli para syve figura e një luftëtari trim të zbritur prej malit. Ai e kishte parë një ditë në rrugë, para shtëpisë së vet. Luftëtari kishte një vështrim të ashpër e të patrembur, i nxirre prej diellit, i rrahur prej erës dhe i veshur me kostumin e fashatarëve të jugut. Mbante pushkë në dorë, kishte flokë të gjatë dhe një vështrim si të shqiponjës që fluturon mbi kreshtat më të të larta të maleve.

Shënim: Fragmentet e mësipërme janë shkëputur nga një seri shkrimesh ndërmjet viteve 1944 -1990 të titulluara “Për Paskalin nga Paskali”





Festojmë së bashku 1 Qershorin!

E diela e 1 Qershorit ka qenë e gjitha për vogëlushët e qytetit. Festa e madhe e fëmijëve ka mbledhur fëmijë të shoqëruar nga prindërit në pjesën qendrore të Parkut "Rinia", ku Bashkia Korçë kishte zbuluar sheshin me larmi ngjyrash, duke e shndërruar këtë pjesë të qytetit në arenë e lojrave, argëtimit dhe festës. Fëmijët e të gjitha moshave duke filluar nga ata të çerdhes deri tek më të rriturit, u argëtuan në këndet e shumta të ngritura enkas për këtë festë. Kanë qenë këndi i lojrave, këndi i pikturës, këndi "Thuaj një dëshirë" dhe ai i vizatimit të ftyrës, të cilat kanë zbatimur fëmijët për orë të tëra.



Nxënës të Mësonjëtores, një orë mësimi në Bashkinë e qytetit

Kanë konkretizuar një orë nga programi i tyre mësimor me dëshirën për t'u njohur me institucionin që drejton qytetin dhe punën për zhvillimin e tij, veçanërisht në përmbushjen e interesave të fëmijëve. Nxënësit e dy klasave të katërta nga Shkolla 9-vjeçare "Mësonjëtorja e Parë Shqipe" zhvilluan një takim me Kryetarin Niko Peleshi në ambientet e Bashkisë.

Kryebashkiaku Peleshi u është përgjigjur një për një pyetjeve të fëmijëve duke premtuar se interesat e tyre janë në vëmendjen e Bashkisë. Këtë vit, Bashkia ka programuar mjaft festa, në mënyrë që ata të kenë më shumë mundësi argëtimi, por edhe projekte të tjera që presin vetëm të konkretizohen, të cilat do t'u krijojnë fëmijëve kushte për të shfaqur e zhvilluar talentin e pasionin e tyre.



Bashkia Korçë gjatë muajve Korrik – Gusht organizon: KAMPIN VEROR DITOR 2008 Për fëmijët nga 6-12 vjeç

Në këtë Kamp fëmijët tuaj:

- Do të zhvillojnë aktivitete argëtuese, edukuese dhe krijuese.
- Fëmijët do të kalojnë 4 orë me bashkëmoshatarët e tyre duke vepruar në grup.
- Një staf mësuësish dhe animatorësh do të sigurojnë zhvillimin e programit dhe supervizimin e fëmijëve.
- Çdo ditë një autobus do të bëjë mbledhjen e fëmijëve për t'u çuar tek Kampi.
- Në 10 ditë fëmijët do të shkojnë në kinema, teatër dhe ekskursione të tjera.

Kampet fillojnë në datë 30 Qershor
Një eksperience, që çdo fëmijë duhet ta provojë!

Festivali i 40-të i Këngës për Fëmijë

Festivali i 40-të i Këngës për Fëmijë u zhvillua përgjatë dy ditëve në datat 9 e 10 qershor. Ai ishte një bashkëpunim i Bashkisë Korçë me Qendrën Kulturore "Mihal Grameno" me udhëheqës artistik Zhani Llogori dhe regji të Vaskë Niços. Në 20 këngët deputuese, kompozime të autorëve korçarë, juria e kryesuar nga Olsa Pema shpalli fituesit. Çmimin e parë e meritoi kënga "Gëzuar pavarësinë" me muzikë dhe orkestrim të Zhani Llogorit, teksti të Koço Dines, interpretuar nga Enxhi Papa dhe Roku Tahirlari.

Kurse interneti falas, zgjerojmë hapësirën e komunikimit

Pranë Bibliotekës “Thimi Mitko”, Bashkia Korçë ka çelur kurse interneti falas për të gjithë të interesuarit veçanërisht për të rinjtë e qytetit. Kjo iniciativë, e cila financohet tërësisht nga Bashkia, është pjesë e projektit “Mësojmë internetin” dhe ofrohet në kuadër të programit “e-City” duke synuar mësimin e programeve bazë të navigimit në internet dhe përdorimit të postës elektronike. Në ditët e sotme kur interneti po bëhet mjete bazë i komunikimit, këto kurse plotësojnë një nevojë të kohës duke përgatitur të rinjtë për një kohë moderne, për kohën dixhitale. Që prej datës 2 qershor, kurset po zhvillohen në sallën e kompjuterave të kësaj biblioteke me një shtrirje kohore prej dy javësh duke iu ofruar falas në vazhdimësi të gjithë të interesuarve. Krahas kursantëve, në kohën tjetër salla e kompjuterave është në shërbim të qytetarëve gjithashtu falas.

Datat e kurseve:

8 korrik – 21 korrik :: 22 korrik- 4 gusht :: 5 gusht – 18 gusht
19 gusht – 1 shtator :: 2 shtator – 15 shtator



PANAIRI I PUNES 2008

...ofrojmë mundësi

PANAIRI I PUNES mundëson kontaktin e biznesit rajonal me të rinjtë e interesuar për punësim.

VITIN E KALUAR “Panairi i punës 2007” mundësoi

- 15 BIZNESE PJESEMARRESE
- 280 TE INTERVISTUAR
- 50 TE PUNESUAR

EDHE KETE VIT “Panairi i punës 2008” OFRON:

PER BIZNESIN:-mundësi reklamimi
- mundësi për të zgjedhur staf të ri

PER STUDENTET: -kontakt me ofertat për punësim
-mundësi konkrete punësimi
-mundësi për të filluar një karrierë



Në Panairin e punës të gjitha shërbimet ofrohen FALAS

BASHKIA KORÇE
.....ofrojmë mundësi





Sport

Zhvillohet në Korçë Kampionati Kombëtar i Peshëngritjes për të rinj

Në datat 2 dhe 3 qershor në Pallatin e Sportit "Tamara Nikolla" u zhvillua Kampionati Kombëtar i Peshëngritjes për të Rinj, U-17. Në të morën pjesë 12 ekipe me 59 sportistë nga të cilët 6 femra. Krahas ekipeve të Partizanit, Tiranës, Tomorit, Elbasanit etj, mori pjesë edhe ekipi i Skënderbeut me trajner Mishel Tele.

Në fund të kampionatit, Sekretari i Federatës Shqiptare të Peshëngritjes Ilir Kraja, shpalli sportistët kampionë të cilët do të marrin pjesë në Kampionatin European të Peshëngritjes që do të zhvillohet në Francë. Vendi e parë në renditje e meritoi ekipi i Tomorit, ndërkohë që në vendin e dytë dhe të tretë u renditën përkatësisht ekipet e Tiranës dhe Elbasanit.

Për herë të parë, Lojrat Rinore Olimpike Rajonale "Korça 2008"

Në datën 31 maj, u zhvilluan pranë Pallatit të Sportit "Tamara Nikolla", Stadiumit "Skënderbeu" si dhe Kolegjit "Preka", Lojrat Rinore Olimpike Rajonale "Korça 2008", me mbështetjen e Bashkisë Korçë, Drejtorisë Arsimore Rajonale dhe Komitetit Olimpik Shqiptar. Këto lojra olimpike u zhvilluan për herë të parë në qytetin tonë. Pas ndezjes së flakës, simbolit të olimpizmit dhe ceremonisë së çeljes së këtyre lojrave, ku përshëndeti edhe Nënkryetari i Bashkisë Arjan Bejko, nxënësit e shkollave 9-veçare nga Korça, Erseka, Devolli dhe Pogradeci, u ndeshën në disa lloje disiplinash si minifutboll, volejboll, basketboll e atletikë, (80m, 400m. kërcim së gjati, shtytje gjyle), lojra që mbajnë peshën kryesore në traditën tonë sportive.

Ekipet e Korçës u paraqitën mjaft denjësisht duke zenë 11 vendet e para nga 13 gjithsej, si për meshkuj ashtu edhe për femra, në garimin individual dhe atë ekipor. Pogradeci ka zënë një vend të parë në garën 800m për meshkuj, ndërsa Bilishti ka merituar vendin e parë në kërcim së gjati për meshkuj.



Vendime

Disa nga vendimet më të rëndësishme të Këshillit Bashkiak

Datë 23.06.2008

- Për përcaktimin e Garancisë Financiare për mbetjet e parashkuara nga ndërtimi dhe prishja
- *Miratim fondi për pjesëmarrjen në Panairin e Luganos (Zvicër), në datat 30 Tetor – 2 Nëntor 2008*
- Mbi dhënien në huapërdorje të objektit të ndodhur në Ndërmarrjen e Shërbimeve Publike, Shoqatës "Romani Baxt Albania", Korçë
- *Për miratimin e përfshirjes së Bashkisë Korçë në Projektin LAMP (Projekti për Administrimin dhe Menaxhimin e Tokës)*
- Për miratimin e sistemit të adresave në qytetin e Korçës
- *Miratim fondi për implementimin e Projektit "Simpoziumi Ndërkombëtar Skulptura e Parkut", Qershor – Korrik 2008*
- Për zmadhimin e kapitalit të UIK-ut dhe emërimin e ekspertit vlerësues

Të nderuar Qytetarë!

Në rast se dëshironi të keni vendimet e plota të Këshillit Bashkiak, mund t'i merrni tek Zyra e Protokoll – Arkivës, në Bashki, çdo ditë nga ora 12.00 deri në orën 14.00

Korça ku → dua të jetoj

Të jesh krenar për qytetin tënd!

Nëse jeni një i apasionuar pas fotografisë, kjo është mundësia jote.

Dërgo foto të qytetit që të bën ty të ndihesh krenar për të.

Ne ju ftojmë të gjithëve të dërgoni foto nga ndërtesat, aktivitetet, festat apo çdo gjë tjetër që ju e keni përzemër, apo ju pëlqen ta shihni.

Çdo muaj, fotot më të mira do të publikohen në faqet e “Qyteti im” dhe në fund të vitit, ju do të keni mundësi të paraqisni punën tuaj në një ekspozitë enkas për ju, ku do të zgjidhet fotoja e vitit.

Kontakte:

Tel: 45755

e-mail: bashkiko@albmail.com

Bashkë me fotot dërgoni dhe një përshkrim të shkurtër të fotos dhe pse e keni zgjedhur pikërisht atë.



Fotoja e muajit: Parku i qytetit
Autori: Keti Tërova

“

Një qytet që po gjelbërohet nga dita në ditë.
Një qytet që jeton!

”

...të rinjtë japin mendimin e tyre mbi zonën këmbësore



... Përse të mos ekzistojë dhe në Korçë një ambient i përhershëm, 24 orë në 24 ku këmbësorët do gjejnë një ishull të qetë larg rreziqeve dhe bezdisjes së makina, ku secili mund të ndalojë një moment dhe ta jetojë qytetin e tij, dhe jo siç ndodh sot kur jemi thjesht kalimtarë të palodhur.....kjo nuk heq mundësinë që xhiroja të vazhdojë edhe në bulevard Republika në orarë e zakonshme.... Korçarët kanë të ngulitur në kokë xhiron, dhe nuk e konceptojnë dot sesi mund të admirohet dhe të jetohej qyteti dhe në prehje.....Unë jam pro kësaj zone...Jam kundër nënkalimit....një zgjidhje e mirë do ishte rregullimi i rrugëve paralele me Bulevardin Shen Gjergji, dhe të rrugëve rreth e rrotull zonës, pra duhet një studim shumë i mirë i rrjetit rrugor rreth kësaj zone për të zgjidhur vështirësitë që do krijonte mbyllja e kësaj arterieje.....

Gjithashtu përfitoj nga tema për të rishprehur një ide timen në lidhje me këtë zonë,,,.Shumë e këndshme do ishte që në këtë zonë të mbilleshin jargavane, duke i alternuar, një të bardhë e një lila....Shpresoj që Bashkia ta marrë në shqyrtim këtë ide për të parë nëse do ishte e udhës apo e mundshme që të zbatohet.....

Çuna unë Jam për **ZONEN PEDONALE**.....Këto zona ekzistojnë në shumë qytete të Europës....Kjo Zonë Pedonale do ishte në vend të ndonjë sheshi qëndor qyteti....E keni vënë re që në Korçë nuk ekziston asnjë shesh i madh që të ishte një ambient urban për relaksin e të gjithëve siç do shndërrohet edhe Sheshi "Skënderbej" në Tiranë në një shesh vetëm në funksion të këmbësorëve.....

Mua personalisht më pëlqen kjo zgjidhje, zona pedonale , nuk besoj se ka si qëllim zhvendosjen e xhiros lol. Po të realizohet ky projekt, Korça do ketë infrastrukturën me moderne në Shqipëri. Uroj të behet realitet!

Rrugët e Korçës nuk janë bërë për trafik të rënduar makinash. Ky kalim i nëndheshëm është zgjidhje gjeniale. Nuk kam lexuar akoma veçse nga do vinë gjithë këto fonde? Ndoshta më ka shpëtuar...

Edhe unë jam për zonën pedonale se do dilte shumë këndshëm por ai bulevard prapë së prapi me duket shumë i shkurtër dhe aflluena e njerëzve do të jetë përsëri tek

Bulevard Republika,kot nuk e thotë dhe ajo kënga "o sa dalë i pirë o nga republika..." ha ha...

Superman, mbase nuk e mban mend....Por ajo këngë nuk i referohet Bulevardit por Lokalit me emrin Republika që ndodhej në krye të bulevardit....Sot është shndërruar në Bingo kati i parë, dhe në bilardo dhe sallë kumari kati sipër.....Ndodhet ngjitur me kinemanë godina e ish Bar Republika.... Dhe po e përsëris se qëllimi i asaj zone pedonale nuk është xhiroja, xhiron mund ta vazhdoni ta beni edhe në bulevard Republika, ajo zonë do shërbejë për t'ua rikthyer qytetin këmbësorëve....nuk e di në e keni parë atë foton e vjeter të Bulevard Republikës ku nëpër trotuare kishte stola për t'u çlodhur, ku janë sot ato stola? E pra edhe Bulevard Republika e ka humbur pamjen që ka pasur kur është konceptuar, mbase mund të them dhe funksionin pedonal....Bulevard Republika është arteria kryesore e Korçës, është shtylla kurizore e saj e si e tillë nuk mund të shndërrohet në zonë pedonale të përhershme, por mund të ruajë farë mirë pamjen që ka sot, duke u kthyer në një zonë pedonale vetëm në orarë e caktuara, pra 18.00-22.00 ose dhe më shumë....Nuk bëhet qameti nëse kthehet në zonë pedonale Bulevard Shën Gjergji, në fund të fundit mund të parkohet fare mirë makina afer vendit ku dëshirojmë të shkojmë dhe pak metra në këmbë nuk do t'i bënin keq asnjëri..



- Përgatitën:
Ana Qeramixhi
Sofjola Kotelli
Mikel Llogori
- Suplement
Benila Tërova
- Ndihmuan:
Stafi i Bashkisë Korçë
Pallati i Kulturës “V.Mio”
Ndërmarrja e Shërbimeve
Publike
Teatri “A.Z.Çajupi”
- Fotot nga:
Ana Qeramixhi
Donald Braholli
Vaskë Niço
Kristaq Sotir
Orieta Glozheni
- Design:
R&T Advertising



Për një qytet ku bashkëjetojnë tradita me modernen, ku të rinjtë realizojnë aspiratat e tyre për shkollim dhe punësim, ku të moshuarit jetojnë ditë të bardha, një qytet që ka gjithmonë një dorë të zgjatur për të nxjerrë nga vështirësia dhe ku problemi yt gjen një zgjidhje. Pas një këthese ecim me vrull në një drejtim të ri për të kapur kohën e humbur dhe për të dalë në krye siç i ka hije Korçës. Ky është identiteti ynë i ri.

Mbështesni “Qyteti Im”



Për më tepër informacion:
Tel: 457-55
e-mail: bashkiko@albmail.com